Komiteti për Politikë dhe Financa
01.Nr.VIII
Deçan,dt.25.09.2025

PROCESVERBAL

I mbajtur për mbledhjen e VII-të të rregullt, mbledhja e VIII-të me radhë e KPF-së, e mbajtur me dt.25.09.2025.

Në mbledhje merrnin pjesë: 7 anëtar të KPF-së, Drejtoresha e Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, Dafina Cacaj, OSBE.

Mbledhjen e kryesoj dhe e udhëhoqi, kryesuesi i KPF-së, z.Hajdar Sutaj.

Për mbledhje ishte propozuar dhe u miratua ky Rend i punës:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Shqyrtimi dhe miratimi i projekt-Buxhetit 2026-2028,
3. Njoftim I Drejtorisë për Arsim për përgaditjen e vitit shkollor 2025/2026,
4. Përkrahje e Kuvendit të Komunës së Deçanit për Deklaratën e datës 19 nëntor 2024 dhe Komunikatës Mbështetëse të datës 16 korrik 2025, mbi eliminimin e të gjitha formave të dhunës ndaj grave në politikë dhe jetën publike në Kosovë,
5. Propozim-vendim për këmbimin e pronës komunale me pronën private,
6. Shqyrtimi i kërkesave;
7. Të ndryshme.

Kryesuesi- e hapi mbledhjen e VII-të të rregullt, mbledhja e VIII-të me radhë e KPF-së për vitin 2025, verifikoj pjesëmarrjen e anëtarëve të KPF-së dhe konstatoj se në mbledhje janë prezent të gjithë anëtarët e KPF-së, pastaj e prezantoj rendin e punës të propozuar me ftesë dhe njëkohësisht propozoj që pika nr.5 të hiqet nga rendi i ditës meqenëse ligji nuk e lejon shqyrtimin e temave të kësaj natyre pas caktimit të datës të mbajtjes së zgjedhjeve lokale nga Presidentja.

Të gjithë anëtarët e KPF-së u pajtuan që pika nr.5 të hiqet nga rendi i ditës së mbledhjes KPF-së dhe po ashtu i Rekomandojnë kuvendit që kjo pikë mos të shqyrtohet as edhe në mbledhjen e Kuvendit të dt.29.09.2025.

Rendi i ditës miratohet njëzëri pa pikën nr.5. Propozim-vendim për këmbimin e pronës komunale me pronën private.

I.Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Njëzëri miratohet procesverbali nga mbledhja e kaluar pa vërejtje.

II.Shqyrtimi dhe miratimi i projekt-Buxhetit 2026-2028.

Kryesuesi- e ka prezentu projekt-Buxhetin 2026-2028, pastaj për sqarime fjalën ia ka dhënë drejtoreshës së Drejtorisë për Buxhet dhe Financa.

Dafina Cacaj drejtoreshë e Drejtorisë për Buxhet dhe Financa ka sqaruar se sipas Qarkores Buxhetore 2026/02 buxheti i Komunës së Deçanit për vitin 2026 është 14,551,974.00€, vetëm për investime kapitale 3,456,413.00€ , për vitin 2027 total buxheti është 14,413,972.00, vetëm për investime kapitale 2,939,657.00€, për vitin 2028 buxheti në total është 15,126,162.00€.

Ndarja buxhetore sipas kategorive ekonomike për vitin 2026 është si vijon: Paga dhe mëditje-8,445,561.00, Mallra dhe Shërbime-2,000,000.00 €, Shpenzime komunale- 300,000.00€, Subvencione dhe trasfere-350,000.00 €, Investime kapitale-3,456,413.00€.

Vatan Istrefaj-ka kërkuar sqarim për disa nga projektet në listën e investimeve kapitale të cilat vit pas viti, qe një kohë të gjatë janë në listë, e disa prej tyre nuk janë nisë fare kurse disa nga ato janë projekte të mëdha që kushtojnë, kurse këtu në listë janë ndarë fare pak mjete financiare për to, ai ka cekë projektin e kanalizimit të ujërave të zeza dhe çka mund të bënë me këtë shumë ka pyet ai, pika 19-blerja e veturave zyrtare vlera 50,00.00 euro, a janë pagua ato që janë ble këtë vit ka pyet ai, pika 32-renovimi i kulmit të QKMF-së kërkon sqarim.

Drejtoresha Dafina- përgjigjet se vlera prej 100.000.00 euro për kanalizim të ujërave të zeza është shumë pak por neve na duhet gjithsesi mi pasë si projekt në listë, duhet me qenë si kod dhe me gjetë mundësi me bashkëfinancim, projektet në vazhdim duhet me qenë në listë se jemi në obligim financiar ndaj tyre.

Faton Selmanaj- ky projekt buxhet ma tepër më duket si buxhet fushate, pastaj ka kërkuar sqarim për projektin me nr.37 në listë- Ndërtimi i ZIP Line dhe produkteve tjera turistike.

Drejtoresha Dafina sqaron se e kemi në listë projekt në bashkëfinancim.

Faton Selmanaj- pyet për punimet në rrugën Elez Geci- Maxhun Berisha, aty vetëm janë qitë bagerat, sqarim kërkon për 50,000 euro projekte në bashkëfinancim, pika 27 bashkëfinancim me CDF dhe fondet IPA.

Drejtoresha Dafina ka sqaruar se duhet të jetë në buxhet i planifikuar kodi i projekteve me bashkëfinancim dhe pastaj gjatë vitit në atë kod hyjnë ato projekte që po miratohen me bashkëfinancim.

Hyri Dobrunaj- thotë, unë kisha dashtë mi votu këtë projekt buxhet, por nuk mund ta votoj për të njëjtat arsye të cilat nuk e kam votuar edhe viteve paraprake, sepse ky buxhet nuk është buxhet i zhvillimit të Deçanit dhe nuk është për të mirën e qytetarëve, në vazhdim ka kërkuar sqarim për projektet në vazhdim, as projektet me IPA nuk i kini qitë as projektet e kryetarit në fushatë nuk i kini planifiku në buxhet.

Yllarta Thaqi- kërkon sqarim për projektet në listën e investimeve kapitale, projekti nr.14-Ndërtimi i shtëpisë rezidenciale- ku do të ndërtohet ai objekt pyet ajo, pika nr.42- ndërtimi i këndit të lojërave dhe për projektin nga pika nr.20 ndërtimi i objekteve memorialë të dëshmorëve të kombit në disa fshatra.

Drejtoresha Dafina ka sqaruar për pyetjet e ngritura.

Kryesuesi e qiti në votim projekt-buxhetin 2026-2028, anëtarët e KPF me shumicë votash e miratojnë ate, rezultati i votimit ishte 4 për(AAK), 2 kundër(LDK), 1 abstenim(VV).

Rekomandim: KPF e kanë shqyrtuar draft buxhetin për vitet 2026-2028, ku sipas Qarkores Buxhetore 2026/02 buxheti i Komunës së Deçanit për vitin 2026 është 14,551,974.00€, vetëm për investime kapitale 3,456,413.00€ , për vitin 2027 total buxheti është 14,413,972.00, vetëm për investime kapitale 2,939,657.00€, për vitin 2028 buxheti në total është 15,126,162.00€, për investime kapitale janë të planifikuara 3,009,455.00€. Debati është koncentruar kryesisht te investimet kapitale ku janë bërë pyetje të ndryshme dhe janë kërkuar sqarime rreth projekteve të ndryshme te lista e investimeve kapitale, për të cilat sqarime ka dhënë drejtoresha e Drejtorisë për buxhet dhe Financa, Dafina Cacaj.KPF pas debatit e kanë përcjellë draft buxhetin 2026-2028 për shqyrtim dhe miratim në Kuvend me shumicë votash, 4-për(AAK), 2-kundër(LDK), 1 apstenim(LVV).

1. Njoftim I Drejtorisë për Arsim për përgatitjen e vitit shkollor 2025/2026.

Rekomandim: KPF kanë pasë vërejtje meqenëse nuk ka qenë prezent në mbledhje drejtori dhe as ndonjë nga zyrtarët e Drejtorisë për Arsim për të sqaruar rreth kësaj teme, si pikë kalon për shqyrtim në Kuvend me shumicë votash (4 për, 2 apstenim, 1 kundër)

2. Përkrahje e Kuvendit të Komunës së Deçanit për Deklaratën e datës 19 nëntor 2024 dhe Komunikatës Mbështetëse të datës 16 korrik 2025, mbi eliminimin e të gjitha formave të dhunës ndaj grave në politikë dhe jetën publike në Kosovë.

Rekomandim: KPF shprehen se e përkrahin këtë Deklaratë, e cila me kërkesën e OSBE-së ka hy në rend dite për shqyrtim dhe miratim dhe këtë pikë e përcjellin për shqyrtim në Kuvend pa debat.

3. Propozim-vendim për këmbimin e pronës komunale me pronën private,

Rekomandim: kjo pikë hiqet prej rendit të ditës së KPF-së dhe rekomandohet që të hiqet edhe nga rendi i ditës të mbledhjes së Kuvendit, kjo në zbatim të nenit 10 të Ligjit Nr.06/L-092, i cili decidivisht përcakton që: Kuvendi i Komunës dhe ekzekutivi i komunës nuk mund të merr asnjë vendim lidhur me dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës nga dita kur Presidenti shpall zgjedhjet lokale.

VI.Shqyrtimi i kërkesave.

1. Kërkesa e komunitetit të fshatit Isniq për mbështetje financiare në vlerë prej 5000 euro për ndërtimin e shtëpisë për nevoja të fshatit Isniq.

Kryesuesi- e ka prezantua kërkesën e komunitetit të fshatit Isniq dhe ka shtuar se shumicën e punimeve të kësaj shtëpie fshati Isniq janë duke i bërë me vetëfinancim, mirëpo për tu përmbyllur ky projekt kanë nevojë edhe për mbështetje financiare nga ana e komunës në vlerë prej 5000 euro.

Drejtoresha, Dafina Cacaj- shprehet se për momentin nuk kemi mjete financiare.

Anëtarët e KPF-së janë deklaruar të gjithë se janë për përkrahje të kësaj kërkese.

Kryesuesi- e qiti në votim kërkesën e komunitetit të fshatit Isniq për mbështetje financiare në vlerë prej 5000 euro për ndërtimin e shtëpisë për nevoja të fshatit Isniq.

Anëtarët e KPF-së njëzëri e miratojnë kërkesën e fshatit Isniq për ndërtimin e një shtëpie të përbashkët për nevoja të komunitetit, në vlerë prej 5000 euro.

5.Të ndryshme.

Në të ndryshme anëtarët e KPF-së janë njoftuar me Shkresën e Ministrisë për rishqyrtim të Draft-Rregullores për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në administratën komunale, e miratuar me dt.31.07.2025.

Anëtarët e KPF-së janë dakorduar që kjo draft rregullore e ndryshuar dhe plotësuar sipas rekomandimeve të Ministrisë të shqyrtohet në mbledhjen e Kuvendit të dt.29.09.2025, anëtarët e Kuvendit të pajisen sot (dt.25.09.2025) në formë elektronike në e-mail adresat e tyre zyrtare me shkresat e Ministrisë dhe draft- rregulloren e ndryshuar dhe plotësuar, ndërsa në mbledhje të kuvendit me nga një kopje fizike të pajisen kryetarët e Grupeve kuvendare.

Vatan Istrefaj- ka paraqitur gojarisht një kërkesë për ndihmë financiare për një djalë të fshatit Strellc i cili është i diagnostikuar me tumor në krye.

Anëtarët e KPF-së u pajtuan që Vatani ta bënë dhe ta bien me shkrim kërkesën dhe KPF ta shqyrton të hënën pas mbledhjes së kuvendit.

Kryesuesi- i falënderoj pjesëmarrësit për kontributin e dhënë pastaj e shpalli mbledhjen për të mbyllur.

Procesmbajtëse, Dyke Llolluni

Kryesuesi i KPF-së
Hajdar SUTAJ